



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA E KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE/NATIONAL AUDIT OFFICE

Në mbështetje të nenit 12.2 të Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe paragrafit 2 (2.3) dhe paragrafit 6 të nenit 10 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-03-212, Zyra Kombëtare e Auditimit, me datën 21 gusht 2017, publikon këtë:

SHPALLJE

Për angazhimin e tre (3) personave për kryerjen e shërbimeve të veçanta në fushën audituese. Angazhimi bëhet me kontratë për punë dhe detyrave specifike për një periudhë të caktuar kohore prej katër (4) muajve, duke filluar nga data 31 tetor 2017 deri me datën 31 janar 2018. Për shërbimet e kryera audituese, kompensimi bëhet në lartësinë e caktuar me aktet e brendshme të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Qëllimi i angazhimit:

Kryerja e auditimeve të rregullsisë së ndërmarrjeve të caktuara publike, donacioneve dhe projekteve të caktuara në bazë të marrëveshjeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit me donatorët e fondeve për institucionet përfituese në Republikën e Kosovës.

Kryerja e shërbimeve audituese:

Puna audituese kryhet sipas detyrave të përcaktuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e zbatueshme të auditimit të njohura ndërkombëtarisht dhe nën mbikëqyrjen e udhëheqësit të ekipit të auditimit.

Kushtet themelore:

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte: Diplomë fakulteti, së paku një (1) vit përvojë pune profesionale në fushën e auditimit, kontabilitetit apo financave. Preferohen trajnime në fushën relevante dhe kualifikime profesionale në skemat e çertifikimit për kontabilitet dhe auditim.

Mënyra e konkurimit:

Kandidatët e interesuar, aplikacionin zyrtar mund ta marrin në recepcionin e Zyrës Kombëtare të Auditimit apo ta shkarkojnë nga ueb faqja e internetit në adresën: <http://www.zka-rks.org/> dhe mund të paraqesin dokumentacionin në kopje fizike në Divizionin për Administrimin e Dokumenteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në adresën: rr. "Musine Kokalari" nr.87- Prishtinë, të aplikojnë përmes ueb faqes elektronike në adresën: rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Kandidatët, aplikacionit duhet bashkëngjitur dëshmitë për kualifikimin shkollor dhe përvojën e punës. Dokumentacioni i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

Shpallja është e hapur pesë (5) ditë, prej ditës së publikimit në shtypin ditor dhe ueb faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin për Burime Njerëzore, në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.